

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “MZ PARTNERS” shpk

Në Tiranë, sot më datë 03 Mars 2023 ne ortakët:

1. Thoma Marko i biri i Vasilit dhe i Liljanës, lindur më 12.10.1982 në Pogradec, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I21012150K, me adresë banimi: Rruga "Xhon Kenedi, pall Solued, kati 4, Ap.22, Tiranë"
2. Diana Zebi, e bija e Faizit dhe e Hatixhes, lindur më 24.01.1963 në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, madhore me zotësi juridike për të vepruar, mbajtëse e ID G35124030C me adresë: sheshi Jozef San Martin, Nd. Pall 3, H14 Ap.9 Tirane Njesia Bashkiake Nr.5, 1019, Tirane.

Me vullnetin tonë të plotë jemi dakortësuar për themelimin e një shoqërie tregtare sipas legjislacionit shqiptar, me termat në vijim:

### Neni 1

Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin tregtar “MZ PARTNERS” shpk dhe formë ligjore: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “SHPK” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

### Neni 2

Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga "Liman Kaba", Olimpik rezidens, Përballë Parkut Olimpik Shkalla 3, Hyrja nr 304, kati 3, Tiranë.

### Neni 3

Objekti i veprimtarisë

- 3.1 *“Shërbime dhe konsulencë financiare, juridike, ndërmjetësimi, tregtare, fiskale, studime tregu, fizibiliteti, hartimi i planeve të biznesit, krijimi i zyrave të përfaqesisë për brande dhe marka të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, shërbime marketingu, shërbime imobiliare, blerje dhe shitje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, marrja dhe dhenia me qera e objekteve të të treteve, përfaqesime tregëtare për biznese vendase dhe të huaja, Çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit Shqiptar.*

Për realizimin e objektit të veprimtarisë shoqëria mund :

- Të lidhë kontrata me klientët qoftë person fizik ose juridik, Shqiptarë apo të huaj.
- Të themelojë partneritete për kryerjen e shërbimeve si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

- Të marrë pjesë me aksione/kuota edhe në shoqëri të tjera vendase, të huaja ose me kapital të përbashkët që kanë objekt shoqëror dhe aktivitet të ngjashëm me të ;
  - Të krijojë filiale dhe zyra përfaqësie në qytete të tjera të Shqipërisë ose në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e tyre.
- 3.2. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund :
- të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
  - të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi.
- 3.3. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.
- 3.4. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës.
- 3.5. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në Statut.

#### Neni 4

##### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është **1.000.000 (Njëmillion )** lekë të reja , i ndarë në 2 kuota të barasvlefshme të cilat zotërohen nga ortakët si më poshtë:

**Thoma Marko** zotëron 1 kuotë me vlerë **510.000(Pesëqinddhjetemijë)** lekë të reja , e cila përbën **51 %** të kapitalit fillestar të shoqërisë.

**Diana Zebi** zotëron 1 kuotë me vlerë **490.000(katëqindnëntëdhjetemijë)** lekë të reja , e cila përbën **49 %** të kapitalit fillestar të shoqërisë.

#### Neni 5

##### Administratori

Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Thoma Marko, për një afat pesëvjeçar, me te drejtë riemërimi

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "MZ PARTNERS"** shpk

**Thoma Marko**

**Diana Zebi**

Thoma Marko  
03/03/2023

Diana Zebi  
03.03.2023